



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna Klinë

Zyra e Kryetarit të Komunës

Nr. 06-33729/23

Klinë, datë: 25.09.2023

PROCESVERBAL

Nga Dëgjim publik me mësimdhënës, drejtorë të shkollave, staf mjekësor si dhe këshillin e prindërve të shkollave, i cili u mbajt në hapësirat e shkollës së mesme profesionale IAAP “Fehmi Agani”, me datë 8 gusht 2023 dhe filloi në orën 19:00, ku morën pjesë: 7 persona.

RENDI I DITES

1. DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS 2024 – 2026

Komuna e Klinës ka vazhduar me debatet me publikun me mësimdhënës, drejtorë të shkollave, staf mjekësor si dhe këshillin e prindërve të shkollave në hapësirat e shkollës së mesme profesionale IAAP “Fehmi Agani”.

Për pikën e rendit të ditës draft-plani i buxhetit komunal i Klinës 2024 – 2026, fjalën hyrëse e mori kryetari i komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj i cili ishte i shoqëruar nga përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, drejtori i Arsimit, z. Qemajl Sejdiu, drejtorë të tjerë të drejtorive si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Kryetari Elezaj pasi një përshëndeti të pranishmit, bëri një prezantim të përmbajtjes së draft-buxheti për vitin 2024. Pasi që pjesëmarrësit ishin që të gjithë drejtorë të shkollave ai informoi mbi procedurat dhe investimet që do të realizohen në Gllarevë, në shkollën fillore e mesme e ulët “Dëshmorët e Qëndresës”, në Leskoc në paralelen e ndarë, SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi” e shumë shkolla të tjera të komunës së Klinës e që sipas tij arsimit dhe ofrimi i kushteve të mira për mësim mbetet prioritet i qeverisjes.

Investimet e ardhshme në shumë shkolla do të fokusohen në zvogëlimin e shpenzimeve si dhe gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për një funksionalizim të këtyre institucioneve. Ndërsa si

planifikime për vitin e ardhshëm parashihen rindërtime të objekteve shkollore si dhe fushave sportive e po ashtu furnizim me inventar.

Pas kryetarit, përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, ju dha fjalën pjesëmarrësve për të diskutuar lidhur me atë që u prezantua nga ana e kryetarit Elezaj si dhe ndarjen e nevojave dhe kërkesave apo edhe ndarjen e sugjerimeve që ata kanë lidhur me buxhetin e viti 2024.

DISKUTIMET DHE KËRKESART

Ndue Balaj – Drejtor në SHFMU “Nënë Tereza” në Budisalc, falënderoi kryetarin për pjesëmarrje si dhe mundësin të bashkëbisedoi me drejtorë të shkollave si dhe nevojat që janë në menaxhimin e tyre, ju uroi suksese gjithë stafit në angazhimin e tyre sidomos për shkollat. Theksoi se shkolla që ai udhëheq deri më tani qëndron mirë dhe që nuk kishte ndonjë kërkesë sa i përket buxhetit.

Xhevdet Bashota – Drejtor në SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në Çabiq, përshëndeti të pranishmit dhe parashitroi kërkesën që shkolla që ai menaxhon ka nevojë për një renovim të brendshëm duke pas parasysh faktin që e frekuentojnë edhe një numër i madh i nxënësve.

Avdi Gashi – Drejtor në SHFMU "Ali Krasniqi" në Ujmirë, parashitroi si kërkesë nevojën e shtrimit të një shtrese asfalt në fushën e sportit të shkollës “Ali Krasniqi”, bazamentit ekzistues, pasi që fusha ekzistuese është dëmtuar në masë të madhe e që tani po paraqet vështirësi për nxënësit dhe mësimdhënëset në realizimin e aktiviteteve sportive.



Gani Ahmetgjakaj – Drejtor në SHFMU "Motrat Qiriaz" në Klinë, kërkoi ndërtimin e një salle sportive sepse kjo shkollë ka talent të shumtë në sport. Shumica janë të regjistruar në akademinë e klubit të futbollit dhe paguajnë të stërviten në shkolla private. E nevojshme si kërkesë tjetër është edhe renovimi i kulmit të shkollës.

Smajl Marmullaku – Drejtor në SHFMU "Tre Dëshmorët" në Jashanicë, theksoi gjatë këtij takimi që shkolla që ai drejton ka probleme me ngrohje andaj duke pas parasysh faktin që mësimi do të filloj në muajin shtator ku jemi në prag të stinës së vjeshtës e dimrit ky problem

kërkon ti ofrohet një zgjidhje e cila është jetike për nxënësit të cilët vijojnë mësimin në këtë objekt.

Ismet Dautaj – Drejtor në SHFMU "Avni Zhabota" në Shtupel, kërkon që të jetë pjesë e buxhetit të vitit të ardhshëm në drejtorinë e Arsimit si projekt, renovimi i brendshëm i shkollës "Avni Zhabota" më saktësisht ndërrimi i dymve dhe dritareve, zëvendësimi më të reja.

Takimi përfundoi në orën 19:33.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	7
Total:	7

Procesmbajtëse:
Vlora Tafili

Klinë, datë: 25.09.2022

